

Njoftim për përqendrim me të cilin Shoqëria Saudite për Elektro-shpërndarje, Arabia Saudite, Saudi Arabian Industrial Investments Company, Arabia Saudite dhe 3D Systems, Inc., SHBA fitojnë kontroll të përbashkët mbi Kompaninë Kombëtare për Inovacione Industriale Arabia Saudite

(Lënda nr. 08-164 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 20.11.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Shoqëria Saudite për Elektro-shpërndarje me seli në Kulla Al-Faisaliah, rruga Mbreti Fahd, distrikti Al-Arid, numri i kutisë postare 22955, Riad 11416, Mbretëria e Arabisë Saudite, Saudi Arabian Industrial Investments Company, me seli në King Khaled International Airport Road, Ndërtesa e Përparme ROSHN H4, numri i kutisë postare 47340, Riad 13413 3686, Mbretëria e Arabisë Saudite dhe 3D Systems, Inc, me seli në 333 Three D Systems Circle, Rock Hill, Karolina e Jugut 29730, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, fitojnë kontroll të përbashkët mbi Kompaninë Kombëtare për Inovacione Industriale, me seli në Ndërtesa 7925, King Khaled International Airport, Riad, Mbretëria e Arabisë Saudite.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste

Shoqëria Saudite për Elektro-shpërndarje është me seli në Riad dhe merret me prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike në të gjithë Mbretërinë e Arabisë Saudite (KSA). Shoqëria zotëron dhe menaxhon rrjetet për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike në KSA.

Shoqëria Saudite për Elektro-shpërndarje nuk ka shoqëri të varura, degë ose përfaqësi në Maqedoninë e Veriut, as nuk realizon qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

Saudi Arabian Industrial Investments Company investon në sektorë strategjikë ekonomikë për të mbështetur zhvillimin e industrive multi-transformuese në të gjithë sektorët industrialë. Aktivitetet e saj përfshijnë pronësinë, zhvillimin, ndërtimin, përdorimin, mirëmbajtjen, shitjen, blerjen, qiradhënien dhe lizingun e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme materiale dhe jo materiale, e njëjta vepron si investitor afatgjatë në projekte industriale që janë në përputhje me qëllimet e Vizionit 2030 të Arabisë Saudite.

Saudi Arabian Industrial Investments Company nuk shet produkte ose shërbime në Maqedoninë e Veriut, dhe nuk është e pranishme në Maqedoninë e Veriut.

Shoqëria Saudite për Elektro-shpërndarje dhe Saudi Arabian Industrial Investments Company realizojnë të ardhura në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërive të varura.

3D Systems ofron zgjidhje gjithëpërfshirëse të printimit 3D dhe prodhimit digjital, duke përfshirë printerë 3D për plastikë, metale, dyllë dhe bio-bojëra, materiale, softuerë, shërbime të avancuara prodhimi dhe vegla për dizajn digjital. 3D Systems i fokuson aplikimet e veta në dy vertikale kryesore industriale: kujdes shëndetësor dhe industri.

Kompania Kombëtare për Inovacione Industriale është kryesisht aktive në ofrimin e shërbimeve të printimit 3D. Këto shërbime përfshijnë prodhimin e objekteve të personalizuar

duke përdorur teknologjinë e printimit 3D, të përshtatura sipas kërkesave specifike të klientëve individualë, e njëjta furnizon edhe harduer për printim 3D (d.m.th. printerë), megjithëse kjo është veprimtari dytësore. Sektorët që shërben Kompania Kombëtare për Inovacione Industriale përfshijnë naftën dhe gazin, energjetikën, mjekësinë, aviacionin, mbrojtjen, industrinë e automobilitave, teknologjinë e informacionit, ushqimin dhe pijet dhe mallrat e konsumit të gjerë.

Për qëllimet e vlerësimit të këtij përqendrimi parashtruesi i njoftimit propozon që si treg përkatës të përkufizohet tregu për shërbime të printimit 3D.

Në bazë të shqyrtimit paraprak Komisioni ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

24.11.2025

Shkup